

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT  
 DHE SPORTIT  
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

## MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE 2024

Lënda: QYTETARI DHE PSIKOLOGJI

### Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim dhe arsytim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Kërkesa	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Kërkesa	15	16	17	18	19	20	21
Pikët							
Kërkesa	22	23	24	25	26	27	28
Pikët							
Kërkesa	29	30	31	32	33		
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

## Qytetari

1. Në Kodin e Punës neni 26, pika 3 përcaktohet: “Gjatë vlefshmërisë së kontratës, punëmarrësi nuk duhet të kryejë asnjë punë të paguar nga të tretët, e cila dëmton punëdhënësin ose i bën konkurrencë atij.”  
Përcaktoni funksionin e ligjit për këtë rast. **1 pikë**

- A) Përmirësues të jetës së njeriut në komunitet.
- B) Sigurues të standardeve dhe cilësisë së jetesës.
- C) Parandalues të dëmeve dhe konflikteve njerëzore.
- D) Mbrojtës të jetës dhe sigurisë së qytetarit brenda dhe jashtë kufijve.

2. Norvegjia renditet ndër shtetet me politikat më të mira për nënat. Gratë, pas lindjes së foshnjave, përfitojnë nga shteti lejen 49 javore me pagesë. Ligji në këtë rast ka vlerë: **1 pikë**

- A) politike.
- B) sociale.
- C) ndërkombëtare.
- D) ekonomike kombëtare.

3. Imazhi satirik paraqet perëndeshën e drejtësisë, Justitian, ku ironizohet parimi i: **1 pikë**

- A) pluralizmit politik.
- B) sovranitetit të shtetit.
- C) barazisë përpara ligjit.
- D) ndarjes së pushteteve.



<https://www.irancartoon.com/site/gallery/gallery-of-the-best-world-cartoon-part-939>

4. Shërbimi shëndetësor është i organizuar në tre nivele. Shërbimi terciar synon të ndikojë në rezultate më të mira shëndetësore përmes praktikave si: **1 pikë**

- A) aktiviteti fizik.
- B) trajtimi i sëmundjes.
- C) vaksinimi popullatës.
- D) ushqyerja e shëndetshme.

5. Në Japoni lulet e qershve po lulëzojnë më herët se zakonisht, për shkak të ndryshimeve klimatike të shkaktuara nga njeriu. Studimi i vitit 2022 nga Universiteti Metropolitan Osaka, evidentoi se çelja e hershme e luleve të qershisë mund të ketë një ndikim në ekosisteme dhe mund të kërcënojë mbijetesën e shumë specieve.

Masat që do të duhet të ndërmerren për mbrojtjen e mjedisit në këtë rast lidhen më së shumti me:

**1 pikë**

- A) parimin “ndotësi paguan”.
- B) plotësimin e nevojave vetjake.
- C) parimin e përgjegjësisë ligjore.
- D) parimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

6. Në samitin e klimës COP26 në Glasgow, liderët botërorë pranuan se nevojitet veprim urgjent në mbarë botën për të përmbyshur objektivin e kufizimit të rritjes së temperaturës globale në 1.5 gradë celsius. Përmbyshja e angazhimeve për reduktimin e emetimeve dhe realizimin e objektivit kërkon përpjekjen e: **1 pikë**

- A) shtetit si aktori i vetëm.
- B) organizatave në mbrojtjen e mjedisit.
- C) institucioneve shtetërore dhe shoqërisë.
- D) shkollave në ndërgjegjësimin e nxënësve.

7. Përgjatë rrugës për të vizituar gjyshërit në fshat, Ajlin ndeshi një tabelë në formë trekëndëshi barabrinjës me kulmin sipër. Sfondi ishte i bardhë, konturi i kuq, kurse simboli brenda tij ishte me ngjyrë të zezë. Ajlin u përball me një sinjal: **1 pikë**
- A) rreziku.
  - B) tregues.
  - C) plotësues.
  - D) urdhërues.
8. Denisi donte të kalonte rrugën, por nuk kishte asnjë vendkalim për këmbësorët. Si këmbësor ai duhet të: **1 pikë**
- A) kalojë rrugën i qetë sepse ai ka përparësi.
  - B) vrapojë për të kaluar sa më shpejt rrugën.
  - C) sigurohet që në rrugë nuk ka mjete në lëvizje.
  - D) vrapojë dhe të ndalojë në rast se afrohet ndonjë mjet.
9. Qëllimi i moratoriumit të gjuetisë ishte përmirësimi i gjendjes së llojeve të faunës së egër. Ky moratoriumi solli efekte pozitive, ku u konstatua rritje e ndjeshme e numrit të shpendëve të egër. Me cilin nga objektivat e mbrojtjes së mjedisit lidhet ky rast? **1 pikë**
- A) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit.
  - B) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.
  - C) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së burimeve ujore dhe ajrit.
  - D) Përdorimi i burimeve natyrore sipas kërkesës për të plotësuar nevojat.
10. Blerta jeton në një lagje të vogël ku pothuajse të gjithë njihen dhe mirëkuptohen me njëri-tjetrin. Këto marrëdhënie rregullohen edhe ligjërisht. Nga kjo bashkëjetesë Blerta ka: **1 pikë**
- A) të drejtë të zgjedh dhe/ose të zgjidhet si anëtare në strukturat e pallatit.
  - B) të drejtë të mos paguaj tarifën e administrimit për banesën që ka dhënë me qira.
  - C) detyrim t'i parashtrijë Asamblesë propozime për administrimin e ndërtesës së banimit.
  - D) detyrim të marrë pjesë në forumet qytetare për administrimin e përbashkët të ndërtesave.
11. Arbëri sapo ka përfunduar studimet në degën e pikturës. Përshkruani tre hapa të liqishëm të cilët janë të nevojshëm për të arritur punësimin e tij. **3 pikë**
- 1) \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
12. Shpallja e pavarësisë në Guinea, u pasua me deklaratat e Francës për pasoja ekonomike nga kjo shkëputje. Përgjigja e presidentit të ardhshëm Toure, ishte: "Nuk mund të ketë dinjitet pa liri. Kur je i sunduar nga të tjerët, humbet nderin dhe kthehesh në qenie njerëzore inferiore. Ne parapëlqejmë të jemi të varfër, por në liri, sesa të pasur dhe në skllavëri." Vlerësoni tre aspekte që tregojnë lidhjen e të drejtave të njeriut me nevojën për t'i plotësuar ato, tashmë që shteti i Guinesë ka fituar pavarësinë. **3 pikë**
- 1) \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

---

13. "Informacioni është oksigjeni i demokracisë."- shprehej R. Xhuliani. Zhvillimi i demokracisë është i lidhur ngushtë me informimin. Përshkruani tre aspekte që tregojnë rëndësinë që ka informimi në zhvillimin e demokracisë. **3 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

14. Një kompani e prodhimit të lojërave elektronike e fokusuar në realitetin virtual, hodhi në treg lojën e re në prag të festave të fundvitit me një çmim të reduktuar, por pa deklaruar se ky ishte çmim promocional. Në imazhin e ambalazhit dhe në reklamën televizive prezantohet i njëjti grup djemsh si në reklamat e tjera, të cilët përdorin lojën. Emri i lojës së re ishte i njëjtë me atë të kompanisë rivale e cila operon në të njëjtën fushë.

Bazuar në rastin e dhënë, shpjegoni tre aspekte negative që vijnë si rezultat i keqpërdorimit të reklamës. **3 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

15. Shkolla e mesme përfaqësohet nga katër ekipe basketbolli, pjesë e të cilëve janë edhe dy nxënës të ardhur nga Siria. Mësuesja e edukimit fizik kujdeset që të përcaktojnë objektivat, të nxis bashkëpunimin përgjatë stërvitjes dhe të festojnë fitoret të gjithë bashkë. Ekipi më i mirë i këtij viti u motivua me certifikatë dhe një shumë parash nga shitja e biletave. Fituesit e vendit të parë organizuan një aktivitet bamirësie më shumë e parave.

Bazuar në shembullin e dhënë shpjegoni katër funksione që realizon shkolla: **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

---

16. Për secilën nga situatat e mëposhtme, jepni një argument për të treguar se cilës kategori (brez) të drejtash i takon.

**4 pikë**

Në përputhje me Konventën e të Drejtave të Fëmijëve, sipas së cilës çdo fëmijë gëzon të drejtën për arsimim cilësor janë marrë masa edhe për shtimin e numrit të mësuesve ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara (AK).

---

---

Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. Në nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garantohet e drejta e çdo shtetasi që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, për të zgjedhur dhe të zgjidhet.

---

---

Sipas vendimit nr. 113, datë 1.3.2023 është përcaktuar paga minimale në vend. Çdo punonjës në shkallë vendi që merr pagën minimale, ka të drejtë të paguhet me 40 000 lekë.

---

---

Konventa e Aarhusit njeh të drejtën e çdo personi për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm.

---

---

---

## **Psikologji**

17. Disa psikologë bënë një studim me një grup të rinjsh, për të parë ndikimin e mjedisit në modelet e sjelljes së tyre. Këta psikologë i përkasin drejtimit: **1 pikë**
- A) biologjik.
  - B) humanist.
  - C) kognitivist.
  - D) bihevjorist.
18. Njerëzit pësojnë ndryshime fizike, mendore dhe sociale kur kalojnë në stade të ndryshme të jetës. Psikologët që përipiqen të kuptojnë dhe shpjegojnë shkaqet e këtyre ndryshimeve i përkasin degës së psikologjisë: **1 pikë**
- A) sociale.
  - B) biologjike.
  - C) së zhvillimit.
  - D) së personalitetit.
19. Tifozët në stadiume sillen dhe reagojnë në mënyra të ndryshme, në varësi të rasteve të humbura, rezultatit të ndeshjes etj. Për të parë sjelljet dhe reagimet e tyre, psikologët përdorin si metodë: **1 pikë**
- A) sondazhin.
  - B) vëzhgimin.
  - C) eksperimentin.
  - D) studimin e rastit.
20. Emocionet janë pjesë e pandarë e jetës sonë. Disa njerëz i shprehin hapur emocionet e tyre, të tjerë mundohen t'i fshehin ato. Pjesa e trurit që është e specializuar në leximin e emocioneve është: **1 pikë**
- A) hipokampusi.
  - B) hemisfera e majtë.
  - C) hemisfera e djathtë.
  - D) formacioni retikular.
21. Joni po përjeton ankth, pasiguri dhe mungesë orientimi në jetën e tij, tashmë që ndodhet në një shtet tjetër. Psikologu i drejtimit kognitivist në terapinë e tij me Jonin do të ishte më i interesuar në: **1 pikë**
- A) identifikimin dhe ndryshimin e mënyrës se si mendon ai.
  - B) eksplorimin e përvojave të tij në fëmijëri për shenja të traumës.
  - C) zbulimin e interesave dhe eksplorimin e mundësive për rritjen e tij.
  - D) teknikat e ndëshkimit e shpërblimit, si parime për të përvetësuar sjellje të reja.
22. Disa njerëz janë të aftë të përdorin shumë mirë trupin në sporte, vallëzim dhe aktivitete të tjera. Sipas Gardner ata kanë të zhvilluar inteligjencën: **1 pikë**
- A) kinestetike.
  - B) natyralistike.
  - C) ndërpersonale.
  - D) brendapersonale.

---

23. Konsumimi i alkoolit shkakton pasoja tek përdoruesit e tij jo vetëm në shëndetin fizik, por edhe në atë mendor e social. Në cilin grup të drogave psikoaktive bën pjesë alkooli? **1 pikë**

- A) Opiatët
- B) Stimulantët
- C) Psikodelikët
- D) Depresantët

24. Era po plotësonte një fjalëkryq dhe për pikën 3 horizontalisht "Kryeqyteti i Francës" ajo shkroi menjëherë përgjigjen pa asnjë hezitim. Ky lloj informacioni ruhet në kujtesën: **1 pikë**

- A) shqisore.
- B) episodike.
- C) semantike.
- D) procedurale.

25. Përgjatë adoleshencës dëshira për t'u pëlqyer apo pranuar nga anëtarët e grupit është mjaft e madhe. Kjo dëshirë i çon ata drejt sjelljeve që njihen si: **1 pikë**

- A) obediençë.
- B) kompiancë.
- C) konformizëm.
- D) përjashtim social.

26. Mendimet e gabuara për veten apo botën që i rrethon, mund t'i drejtojnë disa njerëz drejt sjelljeve jonormale. Drejtimi psikologjik që jep këtë shpjegim për sjelljet jonormale, është ai: **1 pikë**

- A) kognitiv.
- B) biologjik.
- C) humanist.
- D) psikodinamik.

27. Shpjegoni burimin e stresit në situatat e mëposhtme. **4 pikë**

Albani është një nxënës maturant me rezultate të larta. Ai është në dilemë për të zgjedhur mes mjekësisë dhe inxhinierisë kompjuterike.

---

---

Mira është mjaft e shqetësuar sepse prindërit e saj kërkojnë që të dalë me rezultate të shkëlqyera, ndërkohë që ajo nuk ndihet shumë e sigurt.

---

---

Arbeni ndërmori iniciativën për të hapur një biznes të vogël. Për shkak të rënies ekonomike, biznesi i tij dështoi.

---

---

Nga sondazhet e zhvilluara me disa zonja shtëpiake, u vu re se pjesa më e madhe e tyre përjetonin mërzë.

---

---

28. Në ditët e sotme, njerëzit po ndërgjegjësohen për rëndësinë e shëndetit mendor dhe kujdesin ndaj tij, sepse ky dimension i shëndetit ndikon në shumë aspekte të jetës sonë. Vlerësoni ndikimin e shëndetit mendor në tre nga aspektet e jetës. **3 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

29. Adoleshenca njihet si periudha e ndryshimeve të mëdha, por edhe si një moshë e vështirë. Shpjegoni katër vështirësi me të cilat ndeshet një adoleshent në këtë fazë. **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

30. Përpara se të fillonte karrierën e suksesshme si autor, Stefen King ishte shumë i varfër. Pas suksesit të librit të parë motivohet financiarisht dhe profesionalisht për të vijuar veprimtarinë letrare. Plotësimi i nevojave po ndodhte në mënyrë hierarkike, ato evoluon pas plotësimit të kërkesave themelore. Ai shprehej: "Të shkruarit nuk ka të bëjë me fitimin e parave, famën, takimet apo të bërit miq. Tek e fundit, ka të bëjë me pasurimin e jetës së atyre që do të lexojnë veprën dhe pasurimin e jetës së shkrimtarit gjithashtu."

Referuar rastit të dhënë, dalloni teorinë e motivacionit dhe argumentoni një karakteristikë përfaqësuese lidhur me shembullin. **2 pikë**

Teoria \_\_\_\_\_

Argumenti

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

31. Hipnoza përdoret në psikoterapi për qëllime të ndryshme si: pakësimin e ankthit, trajtimin e ecjes në gjumë etj. Shpjegoni dy efekte të gjendjes hipnotike. **2 pikë**

Sugjestionueshmëria \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
Aftësia për të fantazuar \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



---

32. Eva i pëlqen sportet ekstreme. Ajo ka zgjedhur lumin Noce në Itali për rafting, i cili vlerësohet të ketë shkallë të lartë vështirësie. Në momentin që sfida filloi ajo ndihej pak e frikësuar.

Cili është hormoni që sekretohet në këto momente?

**1 pikë**

---

Përshkruani çfarë ndodh në gjëndrën mbiveshkore (adrenale).

**1 pikë**

---

---

33. Në përballjen e radhës për titull në artin marcial të Tai Chi, Joni përdori disa teknika vetëmbrojtje të cilat i dhanë epërsi ndaj kundërshtarit. Ai realizoi lëvizjet Hao, që janë stil i avancuar i Tai Chi. Ndonëse zemra i rrihte fort nga emocionet ai arriti t'i përballoi ato dhe të koordinonte lëvizjet duke ruajtur vigjilencën. Joni kryesoi këtë garë dhe u shpreh se trajnimi i vazhdueshëm në këtë disiplinë e kishte ndihmuar në rritjen e përqendrimit dhe forcës. Ai ka fituar vetëvlerësim dhe ndihet krenar për arritjet.

Analizoni elementet e tre komponentëve të emocioneve për shembullin e mësipërm.

**3 pikë**

Sjelljes \_\_\_\_\_

---

Kognitiv \_\_\_\_\_

---

Fiziologjik \_\_\_\_\_

---